

Nr. 4897 Prot, datë 03/10/2024Nr. 3741 Prot, datë 03/10/2024**KONTRATË TIP PËR DEPOZITIMIN/SHKËMBIMIN/ SHITJEN/ BLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRIVE “KESH” SH.A. DHE “FTL” SH.A.**E lidhur sot më datë 03.10.2024, ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Efimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga z. Erald Elezi, që më poshtë do të quhet “Depozituesi/Shitësi/Blerësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. Albi Gjenerali, që më poshtë do të quhet “Depozitëdhënësi/Blerësi/Shitësi”,

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar;
- Urdhër Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrisë përgjegjëse për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 23, datë 25.03.2009 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “KESH” SH.A. ”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 121, datë 04.04.2023 i Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A, (FTL SH.A) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.199, datë 03.09.2018”;
- Vendimi Nr. 189, datë 06.06.2023 i Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A, (FTL SH.A) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018”;

- Vendimi Nr. 364, datë 15.12.2023 i Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2024”.

Në kushtet kur:

- Në nenin 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet se shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë, do ta tregtojë energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizim në tregun e lirë. Sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.
- Gjithashtu, Furnizuesi i Tregut të Lirë për nevoja të furnizimit të klientëve të saj në treg të lirë ka të drejtë, në mënyrë proporcionale, ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar dhe/ose të përdorë tepricat/depozitën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë.
- Në nenin 5, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet trajtimi i tepricave të prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria publike e prodhimit, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së “OSSH” SH.A.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

“KESH” SH.A. dhe “FTL” SH.A. lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë tip për depozitim, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë për sasinë e pasiguar në treg të parregulluar, sipas rasteve të mëposhtme:

1. “KESH” SH.A. do të quhet “Shitësi” dhe “FTL” SH.A. do të quhet “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike që evidentohet si tepricë e energjisë elektrike mbas mbylljes së bilancit dhe që ka patur destinacion plotësimin e kërkesës për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, të pasiguar në treg të parregulluar, për periudhën kohore 01.01.2024-31.12.2024.
2. “FTL” SH.A. do të quhet “Depozitëdhënësi” dhe “KESH” SH.A. do të quhet “Depozituesi”, për atë sasi të energjisë elektrike të evidentuar si tepricë nga prodhimi i burimeve të rinovueshme pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose tregtimit/plotësimin të nevojave të shoqërisë “FTL” SH.A. Kjo sasi e energjisë elektrike e depozituar, do t’i kthehet/shkëmbehet shoqërisë “FTL” SH.A. për plotësimin e kërkesës për humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimin në tregun e lirë gjatë vitit kalendarik 2024.
3. “FTL” SH.A., do të quhet “Shitësi” dhe “KESH” SH.A. do të quhet “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike e cila evidentohet në fund të vitit e pa kompensuar me energji elektrike për mbulimin e humbjeve dhe furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, për sasinë e pasiguar në treg të parregulluar, ku “FTL” SH.A. ia shet “KESH” SH.A. me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
4. Sasi të energjisë të depozituara/shkëmbyera/shitura/blera gjatë vitit kalendarik, në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, rakordohen

mes palëve bazuar në të dhënat faktike. Në procesin e rakordimit, sasia e energjisë elektrike e depozituar do të jetë ajo sasi e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë së alokuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguruar në treg të parregulluar. Palët kujdesen që gjatë procesit të depozitimit/shkëmbimit, të rakordojnë çdo muaj në përputhje me dispozitat e mësipërme për saktësimin e sasisë së energjisë së depozituar/shkëmbyer.

Neni 2

Detyrimet kryesore të Palëve

1. “FTL” SH.A. përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të konfirmojë me “KESH” SH.A. sasinë gjendje të energjisë elektrike të depozituar, si dhe do të informojë “KESH” SH.A. për sasinë që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar “KESH” SH.A. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për ta furnizuar me sasi energjie elektrike nga prodhimi i kaskadës.
2. “FTL” SH.A. çdo muaj/javë/ditë në avancë planifikon tepricat e pritshme të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes si dhe plotësimin të nevojave të klientëve të saj në tregun e lirë të pasiguruar në treg të parregulluar dhe i dërgon në rrugë elektronike shoqërisë “KESH” SH.A. për t’i depozituar/shitur, si më poshtë:
 - çdo ditë të enjte informacionin për javën në avancë në profil 24 orë;
 - kur është e nevojshme brenda orës 15:00 informacion të përditësuar për ditën D+2 në profil 24 orë;
 - brenda orës 12:00 informacion për ditën D në profil 24 orë.
3. “FTL” SH.A. pas mbylljes së bilancit energjetic dërgon në “KESH” SH.A. të dhëna për:
 - (i) sasinë faktike të prodhimit nga burimet e rinovueshme;
 - (ii) sasinë e energjisë që është importuar nga “FTL” SH.A. për mbulimin e humbjeve;
 - (iii) sasinë faktike të energjisë e cila është përdorur për mbulimin e humbjeve;
 - (iv) sasinë faktike të energjisë e cila është përdorur për plotësimin e nevojave të klientëve të saj në tregun e lirë, të pasiguruar në treg të parregulluar.

Saktësimi i sasive të depozituara/ të shkëmbyera do të bëhet mes palëve pas mbylljes së bilancit energjetic për muajin paraardhës.

4. “KESH” SH.A., në funksion të kapacitetit gjenerues (në rast prurjesh në kaskadë) përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, njofton shoqërinë “FTL” SH.A. mbi mundësinë e prodhimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga “KESH” SH.A. për mbulimin e humbjeve.
5. Bazuar në pozitën e palëve për muajt paraardhës, energjia e llogaritur mbi të dhënat më sipër do të përbëjë:
 - a) energji e depozituar, është teprica nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezulton nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që tejkalon sasinë e pambuluar të humbjeve totale dhe nevojave të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguruar në treg të parregulluar sipas bilancit energjetic të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.
 - b) energji e shkëmbyer, është sasia e munguar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezulton nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që nuk plotëson humbjet totale dhe nevojat e furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguruar në treg të

parregulluar, sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.

Neni 3

Realizimi i transaksioneve

1. Sasia e tepërt e energjisë elektrike nga prodhimi i kaskadës së Drinit, pas ezaurimit të sasisë së energjisë së depozituar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse, i shitet “FTL” SH.A. nga “KESH” SH.A. për mbulimin e humbjeve me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
2. Nëse në përfundim të rakordimit vjetor mes palëve, evidentohet se humbjet janë mbuluar përtej sasisë së energjisë së depozituar nga “FTL” SH.A. në “KESH” SH.A., dhe kjo sasi nuk është pjesë e prodhimit të “KESH” SH.A., atëherë kjo sasi do të faturohet me çmimin mesatar të ponderuar të sigurimit të kësaj energjie nga “KESH” SH.A. në periudhën përkatëse.
3. Transaksionet e depozitimit dhe shkëmbimit të energjisë do të realizohen pa çmim, por me bilance energjitike.
4. Transaksionet e shkëmbimit të energjisë do të realizohen në raportin: 1 (një) njësi e depozituar : 1 (një) njësi e kthyer.
5. Në rast se në fund të vitit, sasia e depozituar e energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi është më e madhe se ajo e kthyer për mbulimin e nevojave të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguruar në treg të parregulluar, atëherë “KESH” SH.A. do të kompensojë në vlerë këtë diferencë energjie, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë.

Neni 4

Çmimi, faturimi dhe pagesa

1. Çmimi i shitjes dhe i blerjes së energjisë elektrike që do të zbatohet në këtë kontratë është ai i miratuar nga Bordi i ERE për energjinë e prodhuar nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
2. Në rastin e shitjes së humbjeve, në përputhje me nenin 3, pika 1 të kësaj kontrate, nga shoqëria “KESH” SH.A. për “FTL” SH.A., Shitësi do t'i lëshojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të energjisë elektrike të dakordësuar nga Shitësi dhe Blerësi për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes. Lëshimi i faturës tatimore do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës së livrimit të energjisë elektrike. Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe të dhënat shoqëruese/sqaruese që lidhen me faturimin.
3. Në përputhje me nenin 3, pika 5 të kësaj kontrate, shoqëria “FTL” SH.A. brenda datës 25 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike, duhet t'i dërgojë “KESH” SH.A. informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi më shumë se ajo e kthyer për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe për plotësimin e nevojave të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, të pasiguruar në treg të parregulluar. Deri më datë 25 Janar për vitin pasardhës, Palët pas marrjes së të dhënave, rakordojnë detyrimin për tepicën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, Aneksi Nr. 1 i kësaj kontrate, dhe lëshojnë faturën tatimore për shitjen sipas pozicionit në rakordim.
4. Pagesa e faturës nga ana e Blerësit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të faturës.
5. Pagesa e faturës e lëshuar sipas rakordimit të pikës 3 të këtij neni, nga pala blerëse realizohet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të faturës pasi palët me marrëveshje, kanë rakorduar dhe shuar me kompensim (netim) detyrimet reciproke që kanë rezultuar përgjatë vitit.

6. Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas legjislacionit në fuqi. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

Neni 5

Mos-Performanca për shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimi të kërkesës për klientët universalë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit;
 - b. pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës;
 - c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes;
 - d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të "KESH" SH.A.
2. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuar në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.
3. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.
5. Në rast të mos livrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslivruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palivruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.
6. Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë

elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

Neni 6

Personat e kontaktit

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme ose e-mail:

Për "FTL" SH.A.	Për "KESH" SH.A.
Administratori i Kontratës	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: + E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë. Cel: E-mail:
Programimi	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Cel:+ 355 672135152 E-mail:
Back Office	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Cel.: E-mail:

Neni 7

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 8

Parashikime kalimtare

1. Palët, bazuar në parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, rakordojnë sasinë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.
2. Ky rakordim mbyllet jo më vonë se data 25.01.2025.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo Kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë.
2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga Enti Rregullator i Energjisë.

Neni 10

Të ndryshme

Kjo kontratë nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje të barazvlefshme, 3 (tre) kopje "KESH" SH.A. dhe 3 (tre) për "FTL" SH.A.

"Korporata Elektroenergjitike
Shqiptare" SH.A.

Erald Elezi

Erald ELEZI
ADMINISTRATOR



"Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A.

Albi GJENERALI
ADMINISTRATOR



Aneksi Nr.1

Akt-rakordim për energjinë elektrike të depozituar/shkëmbyer/shitur/bleurë midis palëve

Emërtimi	Nr	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Njësia kWh	
														Progresivi	
Prodhimi i prodhuesve me përparësi	1														
Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes	2														
Energji për klientët e "FTL" SH.A të pasiguruar në treg të parregulluar	3														
Depozitimi/Shkëmbim	4=1-2-3														

“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” SH.A.

Administrator



“Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.

Administrator

